



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 2026/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit S... SH.P.K, me seli në Prishtinë, NUI:, të cilën e përfaqëson Sh.H, kundër debitorit K... SH.P.K me seli Komuna e Ferizajit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V.Sh, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.175/22 të datës 30.03.2022 të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 22.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit K... SH.P.K dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.175/22, i datës 30.03.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 1,181.18 € (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një euro e tetëmbëdhjetë cent) dhe kamatës ligjore.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.175/22, i datës 30.03.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, me të cilën është caktuar përmbartimi, vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit S... SH.P.K, ndaj debitorit K... SH.P.K, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.175/22, të datës 30.03.2022 për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 1,181.18 € (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një euro e tetëmbëdhjetë cent) dhe kamatës ligjore, për shkak të përmbushjes së detyrimit kryesor.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit S... SH.P.K, ka caktuar urdhrin P.nr.175/22, të datës 30.03.2022, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. 1247-210-001-21 të datës 18.10.2021; Faturës nr. 1304-210-001-21 të datës 28.10.2021; Faturës nr. 1404-210-001-21 të datës 30.11.2021 me të cilin e ka urdhëruar debitorin K... SH.P.K, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura, të paguaj shumën prej 1,181.18 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës deri në pagesën definitive të borxhit kryesor si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Debitori me datën 14.04.2022, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit, duke i propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbarim dhe të obligohet kreditori që të i bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore në tërësi. Ndërsa me parashtresën e datës 21.10.2022, debitori ka njoftuar gjykatën për pagesën e tërësishme të borxhit nga ana e tij, ku si provë ka bashkëngjitur edhe fletë dëftesat nga transaksionet bankare duke i propozuar gjykatës që të përfundohet procedura përmbarimore në tërësi.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 15.11.2022, përfaqësuesi i autorizuar i debitorit ka deklaruar se lidhur me këtë çështje e ka njoftuar gjykatën përmes parashtresës se i ka paguar obligimet në shumën prej 1,181.18 €, e po ashtu e ka njoftuar edhe përmbaruesen private duke i propozuar të njëjtës që lënda të tërhiqet prej gjykatës. Më tutje ka theksuar se përveç shumës për borxhin kryesor në vlerën prej 1,181.18 €, nuk ka paguar shumë tjetër. I ka propozuar gjykatës që mundësisht shpenzimet e procedurës përmbarimore ti paguajnë përgjysmë së bashku me kreditorin.

Kreditori me datën 22.04.2022 ka paraqitur përgjigje në prapësim, ndërsa në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 15.11.2022 i autorizuari i kreditorit ka deklaruar se lidhur me këtë çështje përmbarimore debitori e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit sa i përket shumës prej 1,181.18 €, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore nuk ka informata se e njëjta është paguar. Ka deklaruar se kreditori heq dorë nga kamata ligjore e kërkuar në emër të borxhit kryesor për shumën prej 1,181.18 €, ndërsa sa i përket propozimit të debitorit për pagesën

e shpenzimeve të procedurës përbarimore së bashku me kreditorin ka deklaruar se nuk ka autorizim për ta pranuar një ofertë të tillë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit të dhëna me përgjigje në prapësim, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse të dhëna në seancën dëgjimore dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe deklarimeve të palëve të dhëna në seancën dëgjimore gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, P.nr.175/22 të datës 30.03.2022, në shumën prej 1,181.18 € është përmbushur në tërësi.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga njoftimi i debitorit sipas parashtrësës së datës 21.10.2022, fletë dëftesat nga transaksionet bankare si dhe nga deklarata e kreditorit e dhënë në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 15.11.2022 erdhi në përfundim se debitori e ka përmbushur detyrimin për pagesën e borxhit, në shumën prej 1,181.18 €, andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par.1.2, ku përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor, e kanë humbur efektin, pasi që detyrimi që ka rrjedhur nga këto fatura është përmbushur në tërësi nga ana e debitorit.

Ndërsa në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, në të cilën theksohet se *“përveç tarifës së efikasitetit të përbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përbaruesit privat dhe kreditorit, tarifat tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”*, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij

aktvendimi, meqenëse kreditori i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përbarimore që janë krijuar prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili është lejuar me urdhrin përbarimor të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, P.nr.175/22 të datës 30.03.2022. Andaj gjykata vlerësoi se shpenzimet e përbarimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përbarimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përbarimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përbarimor e la në fuqi, vetëm sa i përket pjesës së shpenzimeve të procedurës përbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, 71 par.1, nën par. 1.2, nenit 73 par.1 dhe 3 të LPP-së nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2026/22, datë 22.11.2022

Gjyqtari

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi
palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,
nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,
në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.